



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 14777 prot

Vlorë, më 12.12.2023

Lënda: Informacion mbi Planin Social të Bashkisë Vlorë

Zj. JONA PLUMBI

Vlorë

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. Prot 14777, datë 23.11.2023, mbi kërkesën për informacion në lidhje me planin e Bashkisë referuar premtimeve të dhëna në fushatën elektorale 2023, ju bëjmë me dije se aktualisht në qytetin e Vlorës është një Qendër për të Moshuarit, ku ofrohen pije të ngrohta si dhe një ambient mikpritës me aktivitete argëtuese ,si shah, domino, letra etj.

Gjithashtu pranë Qendrës për të Moshuarit, ofrohet edhe shërbimi mjekësor si: matja e diabetit, tensionit etj. Për personat në skemën e ndihmës ekonomike, persona me aftësi ndryshe si dhe personat e moshuar të vetmuar, ofrohen tre herë në javë vakte ushqimore. Gjithashtu është dhe Qendra Ditore për të Moshuarit e Bashkisë Vlorë e cila ofron ambient të ngrohtë për të kaluar kohë së bashku, të shkëmbejnë biseda dhe të krijojnë shoqëri nëpërmjet aktiviteteve si lojës së shahut, letrave etj.

Në planin e ri social 2024-2026, Bashkia Vlorë do të ketë ndër prioritetet kryesore transformimin e shërbimeve sociale, nga qendra rezidenciale në qendra shërbimesh komunitare, qendër emergjence me shërbime sociale të integruara.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI

Ermal Dredha

